



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 550/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Joniad Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.12.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Biomedica Albania Distribution*” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-73675-10-01-2020, me objekt: “*Kite dhe Reagentë për Laboratorët e Shendetit Publik.*”, me fond limit 2.500.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 19.10.2020, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Durrës.

Ankimues: “Biomedica Albania Distribution” shpk.
Adresa: Rruga “Eduart Mano”, Pallati Kriger, Kodi postar 1031, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor.
Adresa: Lagjja 4, Rruga “Fetah Billaca”, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.10.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. *REF-73675-10-01-2020*, me objekt: “*Kite dhe Reagentë për Labororët e Shendetit Publik.*”, me fond limit 2.500.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 19.10.2020, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Durrës.

II.2. Në datën 19.10.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 22.10.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "Krijon" shpk	2.148.880 lekë	kualifikuar
2. "Biomedica Albania Distribution" shpk	2.274.000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 22.10.2020, operatori ekonomik "Biomedica Albania Distribution" shpk është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe skualifikimin e tij me arsyetimin si më poshtë vijon:

"Refuzuar për arsye se, në Shtojca Nr.1, Formulari i Ofertës Ekonomike, artikulli me Nr. rendor 125, gabuar sasia. Nga AK kërkuar 292 copë, nga OE 280 copë."

II.5. Operatori ekonomik "Biomedica Albania Distribution" shpk, në datën 29.10.2020 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...]

Me anë të sistemit të APP u njoftuam online në datë 22.10.2020 për skualifikimin e ofertës tonë duke qënë se oferta duhet të ishte më e lartë se ajo e ofertuar realisht për shkak të gabimit në sasi dhe shumëzim.

*Artikulli 125 është vendosë sasia 280 nga sasia e kërkuar 292 (diferenca 12 copë * 3 lekë = 36 lekë total) dhe një diferencë çmimi në total 36 lekë.*

Argumentimi ynë kundra një vendimi të tillë për skualifikimin e kompanisë tonë.

E ankimojmë këtë vendim si totalisht jo në përputhje me parimet e prokurimit publik mbi mosdiskriminim dhe trajtimin sa më objektive, në përbushje të qëllimit për rritjen e konkurrencës, trajtimin sa më objektive të kompanive pjesëmarrëse. Gjithashtu është shkëlur si ligji mbi prokurimet publike dhe mbi rregullat e prokurimit publike dhe konkretisht Neni 66 i Rregullave të PP dhe Neni 53 LPP.

a- Vlera prej 36 lekë përbën 0.0016 % të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar dhe efekti financiar është i pa përfillshëm dhe siç mund të kuptohet është vetëm një gabim aritmetik.

b- Në bazë të Rregullave të Prokurimit Publike, Neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" rreshti 4 thuhet se ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen.

c- Çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shummat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

d- Vlera e gabimit aritmetik është 0.0016 e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

e- Neni 53 i LPP thotë se "Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

f- Kompania jonë nuk është njoftuar për një gjë të tillë dhe për të aprovuar këtë ndryshim.

g- Në bazë të rregullave të PP nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet.

h- Ne nuk kemi patë asnjë komunikim për një gjë të tillë në mënyrë që të pranohet korrigjimin.

Si rrjedhojë në bazë të këtyre fakteve kërkojmë kualifikimin e ofertës tonë dhe korrigjimin e çmimit për këtë diferencë të papërfillshme që ka qënë një lapsus dhe gabim aritmetik nga ana jonë dhe pranojmë korrigjimin e AK.

2- Rrethanat e çështjes

Referuar DST, kriteret teknike kërkohej:

Autorizim nga distributori i autorizuar prej prodhuesit për mallrat objekt i kontratës.

I- Kompania "Krijon" shpk nuk zotëron autorizim nga prodhuesi apo distributoret e autorizuar prej prodhuesve për mallrat objekt i kësaj kontrate dhe më specifikisht:

Autorizimet e lëshuara nuk përfaqësojnë gjithë gamën e kërkuar të produkteve të kërkuara në këtë procedurë prokurimi.

Për KIT/tester (spektrofotometër/testet e ujit) e ujit, prodhuesi i vetëm që përmbush kriteret është kompania "MERC" me distributor rajonal - VARUS doel. Kompania jonë është e vetmja në tregun shqiptarë me të drejtë për t'i ofruar dhe suportuar testet e ujit dhe garantuar cilësinë e shërbimit. Partneri i autorizuar në mënyrë specifike për këtë procedurë prokurimi është Biomedica Albania Distribution.

Kompania "Krijon" e ka humbur të drejtën për KIT/testet (spektrofotometër/testet e ujit) e ujit dhe çdo autorizim që mund të paraqesë nga tregëtare ONLINE është i paligjshëm dhe skenarë i rrezikshëm të cilën ne e kemi paraqitur në një procedurë të mëparshme në KPP të datës 19.03.2019 Nr: 495 për "Blerje kite dhe reagent për laboratorët me DSHP Vlorë."

Kompania jonë në bazë të experiencës me autoritetin tuaj dhe njësi të tjera të kujdesit shëndetësor, vendimeve të mëparshme të KPP të datës 19.03.2019 Nr: 495 kërkon skualifikimi e kompanisë "Krijon".

II.5. Me anë të shkresës nr.823/1 prot., datë 02.11.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar atë me pretendimet si më poshtë:

Në përgjigje të ankesës tuaj protokolluar me tonën Nr. 823, datë 29.10.2020 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi ankesën tuaj, ju bën me dije si më poshtë vijon:

Në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2019 me të gjitha ndryshimet të Prokurimit Publik, Neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe 4, "3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, veteëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. 4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj."

Në përgjigje të argumentave tuaja mbi:

1. Ankimimin e vendimit si total ishte jo në përputhje me parimet e prokurimit publik, Ju bëjmë me dije se oferta juaj nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, duke qënë se lista e kërkesës nga AK (si një dokument standart kryesor i procedurës së prokurimit) është devijuar, kjo nuk përbën një gabim aritmetik, por përbën mospërbushje të kërkesave të tenderit. Si rrjedhojë, përsa më sipër, AK ka të drejtën t'ju skualifikojë.

2. Lidhur me pretendimin tuaj për autorizimet e kompanisë së kualifikuar si fitues nga AK,

Ju sqarojmë se është i pabazuar në fakte ndaj nuk mund të merret parasysh. Megjithatë, për pretendimin se kompania LEL është skualifikuar me po të njëjtat argumente me Vendim të KPP të vitit 2019, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi konsultoi vendimin e lartpërmendur të KPP, Ju sqaron se KPP nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga JU në lidhje me paraqitjen e dokumentave për të cilat Ju ankimoni dhe vërtetoni.

II.6. Në datën 09.11.2020 operatori ekonomik “Biomedica Albania Distribution” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si ato pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 866/1 prot., datë 12.11.2020, protokolluar me tonën në datën 16.11.2020 me objekt “Dërgim informacioni” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k për kundërshtimin e arsyes së kualifikimit sin ë vijim: “Refuzuar për arsye se, në Shtojca Nr.1, Formulari i Ofertës Ekonomike, artikulli me Nr. rendor 125, gabuar sasia. Nga AK kërkuar 292 copë, nga OE 280 copë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1.a, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);”.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 1.1. përcaktohet:

“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

Ndërsa në pikën 1.6. përcaktohet: *Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:*

a) Formularin e Ofertës (Preventivi), plotësuar sipas Shtojcës 1.

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (skica, projekte, etj)

_____,
_____,
_____.

c) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 12.

ç) (opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

III.1.3. Në Shtojcën 1, “Formulari i Ofertës Ekonomike”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1.Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;

2.Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati

Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.4. Në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, shtojca 10, “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR

DURRËS

Lista e Kite Reagentëve për Laboratorët e Shëndetit Publik

Viti 2020

Nr	EMERTIMI	Paketimi	Njesia	sasia
1	<i>Trypton-Tryptofan Medium</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
2	<i>Ekstrakt Beef Poëder (ekstrakt mishi)</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
3	<i>Ekstrakt Majaje</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
4	<i>Simon Citrat Agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
5	<i>Urea Agar Base</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
6	<i>Baird Parker</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
7	<i>L-Arabinozë (C5H10O5)</i>	<i>flakon 100 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
8	<i>Methanol</i>	<i>flak. 2.5 lt</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
9	<i>Sabouraud-Dextrose agar+chloramfenicol</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>5</i>
10	<i>C.L.E.D-Agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>6</i>
11	<i>Desoxycholate-Citrate-agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>2</i>
12	<i>X L D -agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
13	<i>Agar-agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>2</i>
14	<i>E C-Broth</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>10</i>
15	<i>Czapek Dox Agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>2</i>

16	<i>Brom-cresol purple-azideBroth +(glycerol)</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>4</i>
17	<i>Potasium DyhydrogenFosfat KH₂PO₄</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>2</i>
18	<i>DyPotasium hydrogenFosfat (K₂HPO₄)</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>2</i>
19	<i>Kripe Biliare</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
20	<i>Aceton</i>	<i>liter</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
21	<i>Agar-Gjak I gatshëm</i>	<i>pjata petri 90mm</i>	<i>cope</i>	<i>2,100</i>
22	<i>Myeller- Hinton</i>	<i>flak 500gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
23	<i>Kliger Iron Agar</i>	<i>flak.500 gr</i>	<i>flakon</i>	<i>1</i>
24	<i>Acid acetik</i>	<i>liter</i>	<i>liter</i>	<i>1</i>
25	<i>Leter lakmuesi (PH-Indikator)</i>	<i>cope</i>	<i>cope</i>	<i>4</i>
26	<i>Enterotube</i>	<i>teste</i>	<i>teste</i>	<i>10</i>
27	<i>Streptococcus-Grup-A(teste te shpejta)</i>	<i>teste</i>	<i>teste</i>	<i>200</i>
28	<i>Bacitracine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>20</i>
29	<i>Amikacin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
30	<i>Amoxicillin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
31	<i>Amoxiciline+Ac.Clavvulonik</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
32	<i>Ampicilin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
33	<i>Azithromycin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
34	<i>Cefotaxime</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
35	<i>Clarithromycine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
36	<i>Clindamycine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
37	<i>Eritromycine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
38	<i>cefuroxime</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
39	<i>Ceftriaxone</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
40	<i>Ceftazidime</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
41	<i>Cefocitin</i>	<i>50disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
42	<i>Choramphenicol</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
43	<i>Meropenem</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>5</i>
44	<i>Ertapenem</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>5</i>
45	<i>Imipenem</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>5</i>
46	<i>Vancomycine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>20</i>
47	<i>Rifampine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>5</i>
48	<i>Ciprofloxacacin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
49	<i>Doxacyclin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
50	<i>Gentamycine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
51	<i>Ac.nalidixic</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
52	<i>Nitrofurantoin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
53	<i>Norfloxacin</i>	<i>50 disqe</i>	<i>cope</i>	<i>48</i>
54	<i>Sulfomethoxazole+trimethoprim(bactrine)</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>48</i>
55	<i>Tobramycine</i>	<i>50 disqe</i>	<i>disqe</i>	<i>20</i>

56	<i>Levoflocacine</i>	50 disqe	disqe	48
57	<i>Optochine</i>	50 disqe	disqe	10
58	<i>Clotrimazol</i>	50 disqe	disqe	20
59	<i>Nistatin</i>	50 disqe	disqe	20
60	<i>Fluconazole</i>	50 disqe	disqe	20
61	<i>Econazole</i>	50 disqe	disqe	20
62	<i>Ketoconazole</i>	50 disqe	disqe	20
63	<i>Flucitozine</i>	50 disqe	disqe	20
64	<i>Myconazole</i>	50 disqe	disqe	20
65	<i>Amphotericin B</i>	50 disqe	disqe	20
66	<i>Griseofulvin</i>	50 disqe	disqe	20
67	<i>Salmonela Polivalent I</i>	1 ml	ml	1
68	<i>Salmonela Polivalent II</i>	3 ml	ml	1
69	<i>Shigela Flexner</i>	1 ml	ml	1
70	<i>S.E. Coli Polivalent I</i>	3ml	ml	1
71	<i>S.e. Coli Polivalent II</i>	3ml	ml	1
72	<i>S.E. Coli AG Monov. 55 B5</i>	1 ml	ml	1
73	<i>S.E. Coli AG Monov. 121</i>	2ml	ml	1
74	<i>Shigela Sonei</i>	3ml	ml	1
75	<i>Typhy O</i>	flakon ml	ml	2
76	<i>Typhy H</i>	flakon ml	ml	2
77	<i>Test I shpejte HBsAg</i>	test	teste	1,500
78	<i>Test I shpejte HCV</i>	Test	teste	1,200
79	<i>Test I shpejte HIV 1+HIV 2</i>	Test	teste	500
80	<i>Toxoplasmosis (jo aglutinim)</i>	Test	teste	50
81	<i>Brucella Abortus</i>	flakon 5 ml	flakon	2
82	<i>Brucella Abortus kontroll pozitiv</i>	flakon 5 ml	flakon	1
83	<i>Brucella Abortus Kontroll negativ</i>	flakon 5 ml	flakon	1
84	<i>RPR Syphilisis (jo aglutinim)</i>	test	test	1,100
85	<i>ASO</i>	kuti 100 teste	kuti	10
86	<i>CRP</i>	kuti 100 teste	kuti	10
87	<i>RF</i>	kuti 100 teste	kuti	5
88	<i>Reagent per enterosistemin R18</i>	kuti set	kuti	1
89	<i>Helicobacter Pylori (Kit fece)</i>	Test	teste	1,200
90	<i>Fece gjak ocult</i>	Test	teste	600
91	<i>Clamydia</i>	flak 100 gr	flakon	30
92	<i>Nitrat Argjendi AgNO3 0.1N</i>	liter	liter	3
93	<i>Acid sulfurik I perqendruar 98%</i>	liter	liter	2
94	<i>Acid klorhidrik 0.1 N</i>	liter	liter	6
95	<i>Acid fosforik 85% H3PO4</i>	liter	liter	1

96	Alkol 96 % I bardhe	liter	liter	200
97	Diethyl-paraphenylene-diamine	kuti 100 cope	kuti	20
98	Tretesira buferike per normalizimin e pH metrit	cope	cope	2
99	Kromat Kaliumi K ₂ CrO ₄	kg	kg	1
100	Dizifektant per tavolinat	kg	liter	100
101	Dizifektant per duart	liter	liter	100
102	Nesler	liter	liter	10
103	Sulfamil Amid (C ₆ H ₈ N ₂ O ₂ S)	gram	gram	500
104	Kite per spektrofotometer UV 6600-VIS NH ₄	test/kuti	test	1
105	Kite per spektrofotometer UV 6600-VIS NO ₃	test/kuti	test	1
106	Kite per spektrofotometer UV 6600-VIS Fe total	test/kuti	test	1
107	Kite per spektrofotometer UV 6600-VIS NO ₂	test/kuti	test	1
108	Elermajer qelqi 1000ml	cope	cope	3
109	Elermajer qelqi 2000ml	cope	cope	2
110	Pipete 10 ml	cope	cope	20
111	Pipete 5 ml	cope	cope	20
112	Pipete 2 ml	cope	cope	10
113	Xhama mikroskopi (Lama)	cope	cope	1,000
114	Koproxheta (Lamela)	cope	cope	5,000
115	Bishta ansash	cope	cope	3
116	Ansa teli	cope	cope	20
117	Shishe qelqi te autoklavueshme 250 ml	cope	cope	100
118	Maja pipetash 1000µl	cope	cope	500
119	Garze (gjeresia 90 cm)	m	m	100
120	Doreza (kuti 100 cope) Masa L	kuti	kuti	30
121	Doreza (kuti 100 cope) Masa M	kuti	kuti	70
122	Doreza (kuti 100 cope) Masa S	kuti	kuti	50
123	Maska kirurgjikale	cope	cope	4,000
124	Ankeplast	cope	cope	30
125	Age sterile	cope	cope	292
126	Pinceta metalike me maje te sheshte	cope	cope	1
127	Shiringa 2ml	cope	cope	1,000
128	Stativ per mbajtje tubash Ø 25	cope	cope	2
129	Qese te autoklavueshme (autoclave bag)30x60	cope	cope	100
130	Furcë me bisht për larjen e cilindrave + tubave	cope	cope	2
	Total Fondi Limit pa TVSH			

Afatet e lëvrimit: Nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2020

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik “Boimedica Albania Distribution” sh.p.k., në përmbushje të shtojcave përkatëse të dokumentave standarte të tenderit në sistemin elektronik të prokurimeve, ka paraqitur:

- Dokument me emërtim “SHTOJCA_1” pdf.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në pjesën “Udhëzime për operatorët ekonomikë” përcaktohet *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*. Gjithashtu autoriteti kontraktor në këto dokumenta ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas Shtojcën 1 dhe shtojcës 10 ku janë përcaktuar llojet dhe sasinë e produkteve që prokurohen, sikurse është përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Pra, autoriteti kontraktor si në formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 të dokumentave të tenderit, edhe në sasinë dhe llojin e produkteve, bashkëlidhur dokumentave të tenderit sipas shtojcës 10, ka kërkuar që në hartimin e ofertës së tyre operatorët ekonomikë duhet ti përmbahen vetëm këtyre shtojcave.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Biomedica Albania Distribution” shpk konstatohet se në faqen 11 (njëmbëdhjetë) dhe konkretisht zëri i preventivit me numër 125 nga ana e këtij ofertuesi është ofertuar për sasinë prej 280 (dyqind e tetëdhjetë) copë age sterile, ndërkohë që sipas shtojcës 10 të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor në zërin e preventivit me numër rendor 125 është kërkuar që të ofertohej për 292 (dyqind e nëntëdhjetë e dy) copë age sterile, duke mos ofertuar sasinë e kërkuar nga enti prokurues sipas shtojcës 10, por duke ofertuar një sasi më të vogël se ajo e kërkuar.

Sa më sipër, KPP sqaron se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, ndaj dhe të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta. Theksojmë se, përsa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht në formularin e ofertës sipas shtojcës 1 dhe shtojcës 10 ofertimin për një sasi prej 292 (dyqind e nëntëdhjetë e dy) copë age sterile atëherë, në këtë rast, operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin në përputhje me këtë përcaktim, pasi sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomik për procedurën objekt shqyrtimi, përveç faktit që është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij duke ulur sasinë e kërkuar përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomik në një ofertë të pavlefshme.

Sa më sipër, KPP konstaton se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Biomedisa Albania Distribution" sh.p.k. nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit, ndaj do të konsiderohet e pavlefshme.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Biomedica Albania Distribution" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "Biomedica Albania Distribution" sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik "Biomedica Albania Distribution" shpk për procedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim", me nr. REF-73675-10-01-2020, me objekt: "*Kite dhe Reagentë për Laboratorët e Shendetit Publik*", me fond limit 2.500.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 19.10.2020, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1443 Protokoli; Datë 09.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri